

PRANUAR MË:
ACCEPTED DN. 05.06.2024
PRIMLJENO:
02 / 239



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/

Datë: 05.06.2024

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika (d), nenit 40 paragrafi 2 pika d, nenit 53 paragrafi 2, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/ 15, qeshor 2008", në bazë të nenit 13, nenit 23 dhe nenit 35 paragrafi 35.1 shkronja a, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.02/411 datë:14.09.2023, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -IV (katërt) të rregullt të mbajtur me datë: 30.05.2024 merr këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS TË KOMITETIT PËR SHËNDETËSI, MIRËQENIE SOCIALE DHE PERSONA ME AFTËSI TË VEQANTA PËR VITIN 2024

1. Miratohet Plani i punës nr.02/125 datë: 11.03.2024 i Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Persona me Aftësi të Veqanta për vitin 2024.
2. Plani i punës për vitin 2024 përfshinë gjithë punën dhe aktivitetet e përcaktuar nga Komiteti për Shëndetësi, mirëqenie sociale dhe persona me aftësi të veqanta.
3. Pjesë përbërse e këtij vendimi është Plani i punës për Komitetin për Shëndetësi, mirëqenie sociale dhe persona me aftësi të veqanta
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit, përmes Komitetit për Shëndetësi, mirëqenie sociale dhe persona me aftësi të veqanta
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autëritetin mbikqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :
MAPL-së
Arkivit të Komunës
Anëtarëve të Komitetit

Kryesuesi i Kuvendit
Argjend Thaçi



PRANUAR ME:
ACCEPTED ON:
PRILAJENO:
Nr. Me B:

14/03/2024

02.1.125



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Du. / / 2024
Nr. /

Draft: Plani i Punës së Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Persona me Nevoja të Veçanta, për vitin 2024

Objektivat	Aktiviteti	Treguesit e verifikueshëm	Rrcizqet dhe supozimet	Periudha kohore	Komentet
Hartimi, konsultimi dhe shqyrtimi i draft planit të punës, në Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Persona me Nevoja të Veçanta, për vitin 2024.	Takimi me të gjithë anëtarët e komitetit të Shëndetësisë me qëllim të përpilimit dhe shqyrtimit të planit të punës si dhe arritja e pajtueshmërisë për datat dhe orarin e takimeve për vitin 2024	Thirrja e mbledhjeve për takimin me anëtarët e komitetit dhe diskutime rreth planit të punës përpilimi i draftit të ri të punës, në lidhje me planin e punës për vitin 2024	Pasi që anëtarët e komitetit janë persona publik, dhe mund të ketë agjenda të ndryshme, andaj mund ndodh mos thirrja e takimit, mos mundësia dhe gatishmëria e anëtarëve të komitetit për t'u angazhuar në	Janar-Dhjetor 2024	

Pasqyrimi, përcjellja dhe shqyrtimi i rregullt i punës dhe veprime të organeve komunale që bien në kompetencë të këtij komiteti.	Shqyrtimi i pajtueshmërisë së akteve, politikave, praktikave shëndetësore, mirëqenies sociale si dhe personave me nevojë të veçanta, në kuadër të komunës së Malishevës.	Mbajtja e takimeve zyrtare dhe të rregullta të Komitetit për Shëndetësi dhe shqyrtimi i dokumenteve të nxjerra nga organet komunale dhe që janë në sferën që e mbulon ky komitet.	Mos thirrja e takimeve me rregull: Mungesa e kuorumit në takime apo pengesave tjera objektive	Janar -Dhjetor 2024	
	Ngritja e çështjeve të rëndësishme dhe relevante si dhe përgatitja dhe adresimi i rekomandimeve në organet kryesore të organeve vartëse komunale, për kuvendin e komunës dhe kryetarit të komunës.	Numri i çështjeve dhe rekomandimeve dhe te adresuara tek organet relevante vendimmarrëse (kur do që lind nevoja) apo që kërkohet nga institucionet shëndetësore komunale, apo QPS -ja, në lidhje me problemet që i shqyrton ky komitet.	Mos gatishmëria e anëtareve të komitetit për shëndetësi që t'i ngrisin çështjet tek organet komunale Mungesa e interesimit nga organet relevante komunale për trajtim dhe marrje parasysh të rekomandimeve të këtij komiteti.	Janar -Dhjetor 2024	

Vizita në KRU “ Hidroregjioni – Jugor” njësia në Malishevë dhe KRM “ Ekoregjioni “ njësia në Malishevë	Kjo në kuadër të promovimit dhe ruajtjes së shëndetit publik.	Numri i institucioneve te vizituara (9)	Mungesa e interesimit te anëtareve te komitetit për kryerjen e vizitave Mungesa e gatishmërisë se drejtorëve dhe përgjegjësve për takim pengesa tjera të pa planifikuara.	Janar -Dhjetor 2024	
Takime me IRSHP (Prizren)	Te ftohet drejtori i drejtorisë shëndetësi dhe mirëqenies sociale ne takimin e radhës për te raportuar lidhur me projektet 2024	Mbajtja e takimit dhe raporti i përgatitur nga drejtorja e shëndetësisë	Mos gatishmëria e drejtorit për takim	Janar-Dhjetor 2024.	Te kapërcohen te gjitha sfidat me pune te përbashkët te gjithëve
	Te ftohet zyrtari kryesor i Hendikos-it	Mbajtja e takimeve dhe raporteve me Hendikos	Mosgatishmëria e zyrtarit për takim	Janar-Dhjetor 2024	
	Vizitë ne Institutin Regional të Shëndetit Publik i drejtorisë se IRSHP	Mbajtja e dhe informimi i pergjithshem	koha dhe gatishmëria e perfaqesuesve te IRSHP-se	Janar -Dhjetor 2024	

Buxheti për vitin 2024	Te konsultohet kryetari, drejtorja për shëndetësi dhe mirëqenie sociale dhe drejtorja për ekonomi financa dhe buxhet	Konsultime periodike me drejtorite përkatëse	Nuk ka pengesa	Dhjetor 2024	Komiteti do të bashkëpunojë edhe me organet tjera për këtë qëllim.
Përgatitja e raportit të punës për vitin 2024 dhe planit të punës për vitin 2025	Shqyrtimi analizimi dhe aprovimi i raportit vjetor të punës së komitetit për shëndetësi për vitin 2024 dhe hartimi i planit të punës për vitin 2025	Draft raporti për vitin 2024 dhe draft plani i punës për vitin 2025	Mos gatishmëria e anëtareve, apo pengesat objektive të komitetit për përpilim të raportit dhe planit të punës	Dhjetor 2024	Komiteti për shëndetësi debaton lidhur me raportin e punës për vitin 2024 dhe përgatitet për hartimin e planit për vitin pasues, 2025